



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:268126  
Datë: 29.10.2024  
Numri i dokumentit: 06366100

**C-IV-22-0112**

*Ankuesi*

**K O** – trashëgimtare ligjore e **Zh O**, Beograd, Serbi.  
*Përfaqësuar nga av.T B nga Gjakova.*

**Kundër**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.14 tetor 2024 lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e ankuesit dhe **VËRTETOHET** Vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr.PRN092-0918 dt.24 dhjetor 2013.
- Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.31 janar 2014, ankuesi Zh O parashtri ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit ( tutje AL-ja) nr.PRN092-0198 të datës 20 dhjetor 2013, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për paga të pa paguara, në shumë prej 77,000.00€, për periudhën kohore të pa specifikuar nga NSH “ Eximkos” (në likuidim). Në të ankuesi ka pohuar se i është ndërprerë marrëdhënia e punës në vitin 1992, dhe se këtë vendim e ka kundërshtuar. Tutje ka shtuar se i është drejtuar AKP-së me kërkesë për kompensim dhe e njëjta i është refuzuar me vendimin e ankimuar. Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur këto prova Formular i kërkesës për likuidim dhe Aktvendim nr.0101/284 dt.08.05.2002.

Me dt.10 mars 2021, gjykata lëshoj një urdhër për ankuesin që të sjellë vendimin e atakuar, në të cilin urdhër ankuesi është përgjigjur dhe ka sjellë vendimin e lëshuar nga AL-ja. I njëjti është përgjigjur urdhrin përmes postës duke bërë dorëzimin e parashtresës së dt.31 janar 2014 si dhe kopjen e vendimit të kundërshtuar.

Me dt.17 shtator 2021, gjykata lëshoi për ankuesin vërejtje për ta paguar taksën gjyqësore. Me dt.26 tetor 2021, Gjykata Supreme ka pranuar një e-mail nga K M e cila ka njoftuar gjykatën se pala ka vdekur, njëkohësisht ka bashkëngjitur Certifikatën e vdekjes si provë. Andaj, gjykata me aktvendimin C-IV.-14-0570 të dt.28 tetor 2021 e ka ndërprerë procedurën.

Me dt.22 prill 2022 përfaqësuesi me autorizim av. T B përmes parashtresës ka kërkuar nga gjykata se vajza e paditësit tani të ndjer Zh O K(O) M e ka autorizuar duke i dorëzuar certifikatën e vdekjes së Zh O ekstraktin e lindjes së saj, aktvendimin e trashëgimisë të noterizuar për shqyrim të trashëgimisë së të ndjerit me nr.. të dt.. e noterit publik T o nga Beogradi dhe ka propozuar që të vazhdohet procedura duke e trajtuar si palë ankuese trashëgimtare ligjore K O.

Bazuar në parashtresën e dorëzuar për vazhdim të kësaj procedure, lënda merr numrin e ri dhe evidentohet C-IV-22-0112 .

Me dt.04 nëntor 2022 e paditura e ka paraqitur përgjigjen e saj në ankesën e ankuesit, ku ka pohuar se kërkesa e ankuesit është e parashkruar konform nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Poashtu, ka shtuar se meqenëse ankuesi nuk është paguar që nga viti 1993 dhe afati i kërkesës është tri vite e njëjta është parashkruar në vitin 1996. Çdo ngjarje që ka ndodhur pas vitit 1996 është e pa rëndësishme në këtë proces, sepse nuk mund të ndryshoj në mënyrë retroaktive faktin se kërkesa e tij është parashkruar dhe ka kërkuar që gjykata ta refuzoj kërkesën e ankuesit si të pa bazuar.

Gjykata me dt.06 dhjetor 2022 i ka dërguar një urdhër të autorizuarit të ankuesit duke i kërkuar kopjen e librezës së punës, kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kopjen e listës së pagave si dhe prova tjera shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore. I autorizuari i ankuesit i është përgjigjur gjykatës përmes parashtresës së dt.25 korrik 2023 ka bërë dorëzimin e kopjes së librezës së punës, kopjen e aktit SCEL-07-001, kopjen e aktgjykimit SCEL-07-001 dt.22.01.2008, kopjen e urdhërit SCEL-07-001, kopjen e aktvendimit për emërimin e të ndjerit Zh O për koordinator të Filijalës së “Eximkos” në Beograd dt.08.05.2002, Aktvendim për emërimin e Zh O drejtor i “Eximkos” në Beograd, Kralevë dhe Tivar nr.0101/284 dt.08.05.2002.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL-së.

Në pajtim me nenet 2.4 dhe 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se njëra ndër çështjet thelbësore kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit, që si e tillë është çështje e rregulluar me dispozita ligjore dhe meqenëse gjykata konstaton se është parashkruar e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore përmbushjen e detyrimit, pretendimet e tjera të palëve nuk do të shqyrtohen.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh: “kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi;”.

Gjykata gjen se neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76) në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së ishte shfuqizuar me Ligjin mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Ndërmarrjet (GZ 40/89) i cili ligj kishte hyrë në fuqi me 15 korrik 1989, konkretisht me nenin 74, i cili nen e plotëson Ligjin mbi Ndërmarrjet (GZ 77/88, (i cili kishte hyrë në fuqi me 01 janar 1989), konkretisht nenin 196 i cili qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha dispozitave të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, përveç dispozitave nga Kreu IV dhe Kreu i VI kaptina 2, dispozita e nenit 608 është e vendosur në Kreun e VI në kaptinën e 3, që do të thotë se është shfuqizuar me këtë ndryshim plotësim të ligjit. Ligji mbi Marrëdhënien e Punës i datës 14 prill 1989 dhe Ligji për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës i datës 28 shtator 1989, nuk kanë paraparë dispozita të veçanta lidhur me parashkrimin e kërkesave monetare që lindin nga marrëdhënia e punës, megjithatë kjo nuk do të thotë se instituti i parashkrimit për kërkesat monetare ka mbetur i pa mbuluar me dispozita të tjera ligjore.

Gjykata vlerëson se, për kohen kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile lidhur me kërkesat periodike. Këto rregulla gjinden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978, të njëjtat rregulla gjinden edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2012. Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së). Po ashtu, Ligji i Punës nr. 03/L-212 i cili është në fuqi, nuk parasheh dispozitë të veçantë për parashkrimin në lidhje me pagesat e të ardhurave, por parasheh një afat të përgjithshëm prej 3 viteve të parashkrimit, në lidhje me kërkesat që lindin nga marrëdhënia e punës. Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuar në atë kohë, por edhe në ligjet që tani janë në fuqi.

Prandaj, shihet se parashkrimi për pagat e papaguara të kërkuara në këtë lëndë ishte i rregulluar me LMD-në (1978), i cili ishte ligj ende në fuqi në atë kohë. Vetëm në dhjetor 2012 ligji i aplikueshëm ndryshoi, por edhe LMD-ja ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vjetësh.

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar të pagave të pa paguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati sepse ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me pagat e pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Sipas shkresave të lëndës dhe pohimeve të vet ankuesit, i njëjti kërkesën pranë AL-së e ka parashtruar lidhur me tri pagat e pa paguara, në shumë prej 77,000.00€, por në ankesë ka theksuar se i është ndërprerë marrëdhënia e punës në vitin 1992. Po ashtu, nga shkresat e lëndës rrjedh se ankuesi kërkesën për pagat e pa paguara e ka parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit më dt.07 gusht 2007 që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm se ishte parashkruar.

Ankuesi ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit të pretenduar pas çdo muaji të kaluar për të cilët nuk i është paguar paga, kështu që afati i parashkrimit ka rrjedhur për çdo muaj të pagave të pa paguara veç e veç. Kërkesa e ankuesit për pagat e pa paguara, është parashkruar brenda afatit 3 vjeçar, nga se ankuesi kërkesën e ka parashtruar në muajin korrik 2007, që do të thotë jashtë çdo afati të paraparë ligjor.

Ankuesi, me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashkrimit të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore pagat e pa paguara dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar. Ankuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në vitin 1993 ashtu siç ai ka pohuar në ankesën e tij, ashtu që i njëjti është dashur që brenda periudhës kohore prej tri viteve të i drejtohet organeve kompetente për realizimin e të drejtës së pretenduar. Po ashtu, ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë për të dëshmuar faktin se ka iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore apo se ka parashtruar kërkesë për borxhin e pretenduar pranë organeve kompetente para ushtrimit të kërkesës pranë AL-së, kështu do të kishim edhe ndërprerje të afatit të parashkrimit.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi taksën gjyqësore e ka paguar me dt.26.09.2022.

## **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e  
**Hajrie Shala**